

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me Gjykatësin **Drilon Haraçia** dhe sekretaren juridike Valbone Hoxha, në çështjen kontestimore të paditëses F. B. nga Gj. rr. “A.B.” nr., kundër të paditurës Komuna e Gj. – Drejtoria e Arsimit – Gj., baza juridike, kompensim i të pagave pas pensionimit dhe pagave jubilarë, vlera e kontestit 2.580.00 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me **dt.09.10.2018**, në prezencën e paditëses dhe në mungesë të paditurës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PJESËRISHT MIRATOHET kërkesë padia e paditësit F.B. nga Gj., ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit - Gjakovë, që paditëses të ia kompensoj tri paga mujore me rastin e pensionimit në shumën prej 935.46 € dhe për shpërblimin jubilar 50 % të një pagë në shumën prej 155.82 €, në shumën e përgjithshme prej **1.091.28 € (njëmijë e nëntëdhjetë e një euro e njëzet e tetë cent)**, me kamatën përkatëse ligjore 4.5 % në vit, e cila fillon të rrjedhë nga dt.05.04.2018 (data e ushtrimit të padisë), e tutje deri në pagimin definitiv, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II.KËRKESË-PADIA e paditëses F.B. nga Gj., me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit – Gj., që paditëses në emër të kompensimit të ia kompensoj për tri pagat me rastin e pensionimit dhe pagave për shpërblim jubilar edhe pjesën tjetër të mbetur në shumën prej **1.488.72 € (njëmijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë euro e shtatëdhjetë e dy cent)**, me kamatën përkatëse ligjore 4.5 % në vit, e cila fillon të rrjedhë nga dt.05.04.2018 (data e ushtrimit të padisë), **REFUZOHET** si e pa themeltë.

III.DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit – Gj., që paditëses F.B. nga Gj., që në emër të shpenzimeve procedurale të ia kompensoi shumën prej **20,00 € (njëzetë euro)**, në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja pranë kësaj Gjykate ka parashtruar padi për kompensimin e tre pagave me rastin e pensionimit dhe shpërblimit jubilar, kundër të paditurës së lartcekur duke theksuar në padi se paditësi, ka qenë në marrëdhënie të rregullt dhe të plotë të punës tek e paditura dhe ka punuar në cilësinë e mësimdhënësës dhe atë deri në kohën e pensionimit. Pas pensionimit paditëses i takon e drejta e në pagë jubilarë (tri) si dhe e drejta në shpërblim jubilar. Baza juridike të padisë e përbën Kontrate Kolektive të Arsimit Para universitar nr.... të dt.11.04.2015m, sipas dispozitave 36.9 dhe 36.10, andaj ka kërkuar kompensimin në shumën prej 2.580.00 €, me kamatë 4.5 %.

Paditësja në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke shtuar se në bazë të provave të bashkangjitura i propozoi Gjykatës që të aprovoi kërkesë padinë. Shton se në Arsim kam përvojë të punës 16 vite e dy muaj e 14 ditë, ndërsa më herët kam punuar në Model mbi 30 vite. Andaj propozoi Gjykatës që të bëhet administrimi i provave.

Paditësja në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se në bazë të provave të administruara është vërtetuar baza e kërkesë padisë si dhe lartësia, andaj i propozoi Gjykatës që padinë ta aprovoi si të bazuar, duke i kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

E paditura në përgjigje në padi të dhënë me dt.30.04.2018 ka theksuar duke qenë se padinë e tillë të paraqitur në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, brenda afatit ligjor e autorizuara e të paditurës paraqet këtë përgjigje në padi. Sipas dispozitave ligjore të cilat kanë qenë në fuqi të drejtat dhe detyrat e personalit të punësuar në Ministrinë e Arsimit janë të rregulluara me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili ka hyrë në fuqi me dt.01. Nëntor 2010, i cili Ligj nuk ka paraparë asnjë benificon apo privilegj për personat të cilëve ju është ndërprerë marrëdhënie e punës sipas fuqisë ligjore, me mbushjen e moshës së pensionimit (neni 67 paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 i Ligjit nr. 03L-212 i Punës) ndërsa ende është në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut numër 2001/35 e dt. 22 Dhjetor 2001 dhe Rregullorja 2005/20 e dt. 29 prill 2005, për ndryshimin e Rregullores numër 2001/35 mbi pensionet në Kosovë e cila me nenin 4 paragrafin 1 parashikon se administrata udhëheq dhe administron pagesën e pensioneve bazë, për të gjithë qytetarët me banim të përhershëm në Kosovë, të cilët arrijnë moshën e pensionimit dhe paragrafit 2 i nenit të cekur parasheh shumën e pensionit bazë e cila përcaktohet sipas metodologjisë të cilën e miraton Kuvendi i Kosovës. Kontrata Kolektive është e lidhur me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Odës Ekonomike të Kosovës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me dt. 01 janar 2015 andaj për të aplikuar dispozitën e nenit 43 dhe 44 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive ka qenë deshtë që Federata Sindikale E Organeve të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të ketë lidhur kontratë të posaçme me punëdhënësin e vet. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka lidhur kurrfarë kontrate kolektive me Federatën e Punëtorëve të Arsimit dhe në këtë kontest nuk ka kurrfarë obligimi për të zbatuar dispozitën e Kontratës Kolektive e cila kontratë ka hyrë në fuqi me dt. 01 janar 2015. Ish Ministri i MASHT-it z. Ramë Buja me Kryetarin e SBASHK-ut z. Rrahman Jasharaj me dt.11 Prill 2014 kanë nënshkruar Kontratën Kolektive të Arsimit Para universitar, ku sipas nenit 2, zbatimi i kontratës është për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe privat të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë) në mbarë territorin e republikës së Kosovës të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut. Në nenin 36 rregullohet garantimi i pagave dhe sipas pikës 9 anëtarë punëtorët (anëtarë të SBSSHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar siç ka kërkuar paditësja por Kontrata nuk është e zbatueshme dhe nuk mund të ketë efekt retroaktiv. (Kontrata Kolektive e dt. 11 prill 2014 është shfuqizuar sipas nenit 48 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt. 18/04/2017). Bazuar edhe në Kontratën e Kolektive e Arsimit në Kosovë të nënshkruar me dt.18/04/2017 në mes të z. Arsim Bajrami Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe z.Rrahman Jasharaj Kryetar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, ju njoftojmë se përkundër neni 46 të kësaj kontrate, nga ana e MASHT-it dhe SBASHK nuk janë të angazhuar për ti informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate të Ministrisë së Financave me qëllim të realizimit të buxhetit.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 423.4 të ligjit për Procedurën Kontestimore nr.38/2008, të publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikën së Kosovës” me dt.20.09.2008, shqyrtimin përgatitor dhe shqyrtimin kryesor u mbajte në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt siç shihet nga flete dërgesa, të cilën e ka pranuar me dt.12.09.2018, mirëpo mos prezencën nuk e ka arsytuar, ndërsa me propozimin e palës paditëse Gjykata shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesë të paditurit.

Gjykata pas vlerësimit të fakteve juridiko-relevante të kësaj çështje, çmuarjes së provave materiale, dhe në mbështetje të nenit 8 të ligjit për Procedurën Kontestimore nr.38/2008, vërtetoi se kërkesë-padia e paditëses pjesërisht është e bazuar dhe si e tillë pjesërisht u miratua.

Gjykata në procedurën e administrimit të provave nxjerri si prova; kërkesës së paditëses të dt.04.04.2018, drejtuar Komunës së Gjakovës – Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë, për kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse, Vendimit të lëshuar nga Komuna e Gjakovës të dt.18.01.2018, me nr. të referencës zyrtarisht 04/118/02-777, Vërtetimi i lëshuar nga SBASHK-u të dt.28.03.2018, Transakcioni i xhirollogarisë së paditëses të lëshuar nga Pro Credit Bankë me dt.05.04.2018, Vendimi i lëshuar nga Qeveria e Kosovës – MPMS Departamenti i Pensioneve të dt.16.03.2018, lidhur me miratimin e kërkesës për pension, Vërtetimin e lëshuar nga SHMU “M. K.” - Gjakovë me nr. 54-2/2018.

Nga kërkesës së paditëses së dt.04.04.2018 drejtuar Komunës së Gjakovës- Drejtorisë së Arsimit - Gjakovë, e njëjti ka kërkuar nga organi i lartcekur kompensimin e tre pagave me rastin e pensionimit dhe pagat jubilarë duke i cekur dispozitat ligjore sipas kontratës kolektive.

Nga Vendimi i lëshuar nga Komuna e Gjakovës të dt.18.01.2018, me nr. të referencës zyrtarisht 04/118/02-777, paditëses iu është ndërprerë kontrata e punës me dt.31.03.2018 për shkak të daljes në pension.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SBASHK-u të dt.28.03.2018, vërtetohet se paditësja ka qenë anëtare e sindikatës deri në pensionim nga Drejtoria e Arsimit në Gjakovë.

Nga transaksioni bankar i paditëses të lëshuar nga Pro Credit Bankë, me dt.05.04.2018, ma rastin daljen së pagesës në xhirollogarinë e paditëses vërtetohet se si page mujore në neto ka pranuar shumën prej 311.65 €.

Nga vërtetimin i lëshuar nga Qeveria e Kosovës - MPMS – Departamenti i Pensioneve në bazë të kërkesës së paditëses me nr.307214 të dt.14.03.2018 paditëses me dt.16.03.2018 iu është miratuar kërkesë e paditëses për njohjen e të drejtës së pensionit në shumën mujore prej 186.00 €.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHMU “M. K.” – Gj. me nr. 54-..., vërtetohet se paditësja F. B. ka qenë në marrëdhënia pune në shkollën e lartcekur prej dt.17.01.2002 deri me dt.31.03.2018, në kohëzgjatje prej 16 vite, e 2 muaj dhe 14 ditë. Po ashtu pagat e fundit të vitit 2018, në bruto ka qenë në shumën prej 343.27 €.

Sa i përket bazës së kërkesë-padisë, Gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka qenë e punësuar tek e paditura që nga dt.17.01.2002 deri me dt.31.03.2018 ku edhe me dt.14.03.2018 e njëjta është pensionuar, andaj paditësja me rastin e pensionimit ka kërkuar nga e paditura kompensimin e tri pagave me rastin e pensionimit dhe shpërblimin jubilar, ku Gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore tek Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë, sipas së cilës me dispozitat e nenit 35.8 ku citohet se ***“Punëtorët që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: 8.1 për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë 50% të një page bazë. 8.2 për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë 75% të një page bazë. 8.3 për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. 8.4 për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë. 8.5 Shpërblimet jubilarë paguhen nga punëdhënësit ku i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse. Dhe më tutje, sipas dispozitave të nenit 35.9 “Punëtorët (që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”***. Andaj Gjykata erdh në përfundim se kërkesë-padia e paditëses është pjesërisht e bazuar, pasi që me rastin e daljes së paditëses në pension me dt... ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë e

dt.18.04.2017 e jo kontrata e cekur nga paditësja në padi Kontrata Kolektive e Arsimit Para universitar e dt.11.04.2014, andaj Gjykata paditëses ia ka aprovuar kërkesë-padinë sa i përket tri pagave prej nga 311.65 €, në kuptim të nenin 35.9 të Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017 dhe 50 % të një page të fundit në shumën prej 155.82 €, ne kuptim të nenin 35.8 pika 8.1 ku për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë 50% të një page bazë, ndërsa kjo Gjykate vërtetoi faktin se paditës tek punëdhënësi i fundit i ka mbi 16 vite mirëpo nuk i ka kaluar 20 vite që të kategorizohet më lartë, çka do të thotë se kërkesë-padie e paditëses në shumën e përgjithshme është aprovuar në shumën prej 1.091.28 €, ndërsa pjesë tjetër e kërkesë-padisë së kërkuar në shumën prej 1.488.72 €duhet refuzuar si e pa bazuar, pasi që e njëjta bazohet është kalkuluar gabimisht dhe se kjo kërkesë bazohet në Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar të dt.11.04.2014, e cila nuk është në fuqi.

Sa i përket lartësisë së kërkesë-padisë Gjykata vendimin e bazoi në provat si; nga transaksioni bankar i paditëses të lëshuar nga Pro Credit Bankë me dt.05.04.2018, ku paga e fundit në neto ka qenë në shumën prej 311.56 €, po ashtu nga vërtetimi i lëshuar nga SHMU “M. K.” – Gj.vërtetohet se paditësja ka pranuar bagë bruto në shumën prej 343.27 €, andaj Gjykata duke marrë për bazë që paga e paditëses në neto ka qenë 311.65 dhe duke e llogaritur për tre muaj dhe 50 % të një page të fundit në shumën prej 155.82 €, del se lartësia e kërkesë-padisë së aprovuar është në shumën prej 1.09.28 €, andaj Gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata vlerësoj pretendimet e palës së paditur lidhur mirëpo pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se Gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka dal në pension me dt.14.03.2018 ndërsa Kontrata Kolektive është e lidhur me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Odës Ekonomike të Kosovës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me dt.01 janar 2015, nuk duhet të zbatohet tek paditësja, por tek paditësja në kohën e daljes në pension ka hyrë në fuqi kontrata kolektive e dt.18.04.2017, po ashtu lidhur me planifikimin e buxhetit për pagat e tilla pala paditësi nuk është fajtor lidhur me planifikimin e buxhetit pasi që më këtë merren organet shtetërore, andaj pretendimet të tillë kjo Gjykatë nuk e mori parasysh duke i konsideruar të njëjtat pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes, nga se nuk kishin mbështetje ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marr bazuar në nenin 452.1 të LPK-së dhe paditësit ia njoh shpenzimet procedurale për shpenzimet gjyqësore në shumën e përgjithshme prej 20.00 €.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.176/18, dt.09.10.2018

GJYKATËSI
Drilon HARAÇIA

UDHËZIM JURIDIK ; Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditësh, pas marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë e nëpërmjet kësaj Gjykate.